Suplementi i së dielës te SHQIPTARJA.com

E-mail: rilindasi@gmail.com

RILINDASI

Viti III - Nr:23 E diel, 9 qershor 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online

WWW.SHQIPTARJA.COM

ALEKSANDER MOISIU

Max Reinhardt: Si e zbulova gjeniun e skenës

NGA PJETER LOGORECI

Meritat e Max Reinhardit në teatrin gjerman janë shumë të njohura: ishte ai që solli në skenë e i ngriti në sukses një grup të madh aktorësh, të cilët u bënë pjesë e historisë së teatrit gjerman që mund të thuhet "u shkrua" nga i madhi Max Reinhardt.

Merita e madhe e Reinhardit ishte jo vetëm se solli një mënyrë të re në artin skenik, por edhe se ishte zbuluesi i shumë talenteve, më shumë se kushdo tjetër në Teatrin Gjerman. Ai nxorri talente nga masa e madhe e aktorëve të kohës, nga kryeqyteti Berlin, nga periferitë, njerëz që nuk kishin dalë asnjëherë në skenë apo që i kish parë vetëm në prova, e pastaj me durim solli në dritë dhuntinë e talentin që gjindej në secilin prej tyre.

NË FOTO: (*Majtas*) Moisiu me Tristan Bernard, Minister Becker, Max (*lart*) Në qendër të fotos Max Reinhardt dhe Aleksandër Moisiu

Nga të gjithë këto zbulime, ajo e Aleksandër Moisiut ishte më e përmendura. Jo vetëm se ishte talenti më i madh që kishte gjetur, por sepse për ta mbajtur e për ta zhvilluar atë ju desh shumë guxim dhe energji si për askënd tjetër në karrierën e tij. Njerëzit të cilët e quanin Reinhardtin gjuetar me instinkt talentesh, ishin të bindur që ai ishte gabuar me Moisiun. Reinhardti e provoi me durim Moisiun në të gjitha mënyrat, në role të mëdha e të vogla, në drama e komedi, muaj pas muaji, vite me rradhë, e në Berlin pat shumë autorë pjesësh teatrore që e ironizuan dhe e tallën Reinhardtin për këtë.

Në të vertetë asnjë drejtor tjetër teatri, nuk i trajton bashkëpunëtorët si Reinhardti Aleksandrin tonë. Së pari drejtuesi është i interesuar për fitimin që mund të sigurojë nga aktori e më pas...

vijon në faqen 14-15

Arbëreshët/ Ikonat bizantine të Shën Palit

ROSANGELA PALMIERI

Shën Pali Arbëresh. Vendet e kultit të këtij komuniteti arbëresh janë qendra të riteve dhe ikonografisë bizantine. Fjala "Ikonë" vjen nga greqishtja "eikon" që do të thotë imazh, portrete fetare të pikturuara në dru. "Ikona është rezultat i traditës fetare, është një vepër e artit të medituar gjatë, punuar me durim nga brezat", thotë Rosellina Mele, një artiste e re në Shën Pali, e cila ka korrur sukses në këtë art fetar. Diplomuar në Institutin e Artit "Pier De La Francesca" në Arezzo të Toskanës , zbuloi...

faqe 20

Dimensioni universal i figurës së Skënderbeut përmes një monografie

Mbi veprën e Virgjil Kules "Gjergj Kastrioti Skënderbeu-Kryqëtari i Fundit". Autori nuk rrëfen një sagë Skënderbejane për hir të historisë, por nxjerr në pah diplomacinë, lojën për pushtet dhe strategjinë panevropiane të Skënderbeut

DORIAN KOÇI

Figura e Skënderbeut është një subjekt që mund të ketë bibliografinë më të madhe në Bibliotekën Kombëtare. Për të kanë shkruar albanologë, shkrimtarë romantikë, studiusë shqiptarë etj. Si një nga figurat më të mëdha të etnosit dhe kombit shqiptar, në mos më e rëndësishmja , ajo është bërë një subjekt i gjithfarë gjinive letrare, i monografive serioze, i historive lokale dhe kombëtare dhe i miteve dhe legjendave popullore. Për këtë arsye, shkrimi i një biografie apo studimi të ri për të në formën e një monografie , është një sfidë e madhe që kërkon pasion dhe vullnet për të hyrë në labirinthet e historisë, diplomacisë dhe fisnikërisë Skënderbejane por mbi të gjitha kërkon seriozitet dhe skrupuluzitet shkencor për të ditur të gjesh fillin e Arianës nëpër këto labirinthe monopate të mbuluara shpesh herë nga pluhuri i kohës por në shumë raste edhe nga dashakeqësia për ta minimizuar figurën e Gjergj Kastriotit. Për të gjitha veprat monografike që shkruhen për Heroin Kombëtar të shqiptarëve, dashje pa dashje egziston si një etalon matës vepra klasike Barletit, që edhe pse shpesh herë studiuesit e mëvonshëm kanë zbuluar dhe vërtetuar që ka lapsuse përsa i përket fakteve historikë...

faqe 17

Ja, po përflaken edhe krahët e zogjve....

MIRELA GEGPRIFTI

faqe 16

Letërsia arbëreshe më shumë e arkivuar se e botuar

Letërsia romantike arbëreshe në filtrin filologjik të Matteo Mandala-së. E gjithë puna kërkimore e studimore e Mandalà-së mbështetet në radhë të parë në kërkimet arkivore dhe në zbulimet e burimeve dokumentare

KASTRIOT MARKU

Gjuha, të folurit dhe letërsia e arbëreshëve të Italisë kanë qenë dhe mbeten ende disa nga përbërësit më esencialë në ruajtjen dhe gjallimin e shpirtit arbëresh përgjatë pesë shekujve të shkuar, duke luajtur kështu një rol të jashtëzakonshëm në ruajtjen dhe pasurimin e kësaj bote kulturore krejt të veçantë. Përgjithësisht trashëgimia letrare arbëreshe i është paraqitur lexuesit të zakonshëm dhe atij profesional brenda kufijve zyrtarë të shtetit shqiptar, në trajtë të shqipëruar me përshtatje në gjuhën standard, zgjidhje kjo jo e qëlluar, e cila i ka nxjerrë këto vepra nga hullia reale teksteve të veprave letrare të autorëve të tyre. Lexuesi shqiptar u njoh me këto botime, pa mundur pothuajse kurrë t'i shijojë këto tekste si të tilla, pa mundur dot asnjëherë të kuptojë kumtin gjuhësor dhe atë letrar në vijimësinë e tyre historike, duke patur si shenjë bazike gjuhën e këtyre teksteve. Përtejdeti, përveçse si një përfytyrim territorial i lidhur me konturet e lidhjeve etnike gjuhësore e letrare, iu përcoll publikut të vendit të origjinës si një materie gjuhësore e letrare për përdorim masiv, e adoptuar kjo pa një kriter të qartë, por vetëm si një përdorim utilitar përnjohës, shpërfytyruar dhe shkuptimësuar vajtueshëm. Kthimi...

faqe 18-19

Cyan magenta yellow black

FAKTE | TË PANJOHURA

(Foto 1) **Në qendër të fotos Max Reinhardt dhe Aleksandër Moisiu**
(Foto 2) **Moisiu me Tristan Bernard, Minister Becker, Max**

MAX REINHARDT

Si e zbuloi gjeniun e skenës Aleksandër Moisiu

Përballja e parë e mjeshtrit të regjisë me aktorin e talentuar ishte me një rol super të vështirë një monolog që Moisiu e solli mjeshtërisht edhe pse nuk e njihte gjermanishten

NGA PJETER LOGORECI

vijon nga faqja 13

...kërkon të bindet për talentin e tij skenik. Përpjekja e pashembullt e Max Reinhardtit për të sjellë drejt suksesit Moisiun, është një ndër të paktët kapituj të historisë të teatrit gjerman që të bën përshtypje për moralin pozitiv.

Reinhardt kujton: Sapo ishte krijuar në Berlinin lindor një teatër i vogël (1904 - "Vorstadtbühne"), me deshira shumë të mëdha, por me mundësi ekonomike shumë të vogla. Aty mblidheshin aktorët e rinj të panjohur, me pak talent e të varfër, të cilët mundoheshin të aktivizoheshin e të tregoni talentin e tyre. Kisha dëshirë të vija në skenë Genoveva-n e Hebbels-it. Elementët e talentuar më mungonin e kjo më bëri të humb durimin tim profesional. Vendosa më vehten time të mbaj pak distancë, nga dëshirat e mija për të vënë në skenë këtë pjesë, e pamundësisë për të gjetur elementet (aktorët) që më duheshin.

Isha i lodhur dhe i zhgënjyer, kur ... papritur qëndron në skenë perpara meje një i ri i panjohur i cili fillon të bëjë rolin e Golos. Duhet të theksoj se Golo është ndoshta figura më e vështirë nga të gjitha rolet për tu interpretuar, sepse teksti është pothuaj i tëri një monolog, brenda të cilit krijohen situata të ndryshme, nga ajo e brendshme e personazhit në kohën e tashme, e më pas në të kaluarën.... Autori Hebbel ka shkruar një formë të pazgjidhur e shumë të veshtirë dialogu, duke i veshur personazhit ndjenjën djallëzore të dobët e dyshuese të Luzifer-it, por edhe të dashuruarit njëkohësisht....fjalët e tij rrjedhin në disa raste të vetëdijëshme si rryma uji drejt pellgut të madh plot siguri, e që këtë figurë nga 100 aktorë, 50 prej tyre do të krijonin dashnorin klasik, kurse 49 të tjerë dashnorin patetik e të pa jetë. Mendimet e këtij personazhi nuk munden të jenë si një rreze drite që ndriçon e qetë e normal, ato duhen të dalin verbuese e shpërthyese nga një gjoks njerëzor që digjet e që do të ndezë zjarre të tjerë të rinj... Për këtë rol, aktori duhet të "ndizet flakë", por ai aktor të cilit nuk i mungon shpirti shpërthyes dhe i zjarrtë. Ky aktor duhet që më pas të jetë në gjendje që teknikisht këtë lumë fjalësh të monologut ta vendosë në lëvizje, e si në levizjet fizike të memecëve, të shprehë çdo mendim e çdo emocion të tij. Unë personalisht nuk njoh një detyrë më të vështirë në të gjithë fushën e literaturës teatrore se interpretimi i Golos. ... E në këtë rast (nga Moisiu) kjo detyrë ishte e zgjidhur me mjeshtri e talent, nga një aktor i cili nuk e fliste gjuhen gjermane, e cila i krijonte paqartësi e pasiguri, por nga e cila pa pushim ai arrinte të reflektonte pasion dhe emocion.

Ai arrinte që me energji të papara fizike ti jepte çdo mendimi

> Ata që e quanin Reinhardtin gjuetar me instinkt talentesh, ishin të bindur që ai ishte gabuar me Moisiun. Reinhardti e provoi me durim Moisiun në të gjitha mënyrat, në role të mëdha e të vogla, në drama e komedi, muaj pas muaji, vite me rradhë, e në Berlin pat shumë autorë pjesësh teatrore që e ironizuan dhe e tallën Reinhardtin për këtë...

Die Reinhardt-Feier im Deutschen Theater. *Von links:* Tristan Bernard, Minister Becker, Reinhardt, Oberbürgermeister Böß, Gerhart Hauptmann, Gustav Rickelt

Moisiu: Mua më deshti Zoti shumë pasi më dërgoi te Max Reinhardt-i

Fjalët emocionuese në një letër falenderimi të bashkëshortes së Moisiut për Reinhardt-it

Nga kërkimet mbi jetën e Moisiut që kam bërë në Vjenë, gjeta një letër falenderimit që bashkëshortja e Aleksandër Moisiut, aktorja Johanna Terwin i dërgoj Max Reinhardt-it mbas vdekjes së Moisiut, në shenjë falenderimi. Këtu po shkruaj rreshtat e kësaj letre në gjuhën shqipe.

BISSONE / LUGANO PRILL 1935

Shumë i nderuar dhe i dashur Zoti Profesor!

Nuk e di nëse apo kur mund t´Ju arrijnë këto rreshta. Ju falenderoj shumë për fjalët ngushëlluese mbi vdekjen e burrit tim të dashur, Aleksandër. Ai vdiq ndër krahët e mij e me zemrwn e tij të madhe, ma copëtoi zemrën time. Pas kësaj, pyes veten: çfarë ndodhi, çfarë bëj unë akoma këtu, kur shkëlqimi dhe rrezet e diellit, përkujdesjet dhe shqetësimet shkuan me të. Besoj se Ju mendoni kurdoherë vetëm mirë për të. Nga shumë mendime, të cilat ai na la me shkrim, gjeta edhe rreshtat në të cilat thoshte: Mua më deshti Zoti shumë, pasi më dërgoi te Max Reinhardt-i. Po ju dërgoj me këtë letër edhe foton e fundit të Aleksandrit tim. Ai vdiq ashtu si deri në fund jetoj, plot mirësi. Guximi dhe zemërgjerësia e tij e papërshkrueshme nuk e lëshuan deri në frymën e fundit. Unë dëshiroj t´Ju falenderoj shumë për gjithçka që keni bërë për burrin tim.

E Juaja k

Johanna Moissi - Terwin

(*Foto 3*) Ansambli teatror i Max Reinhardt-it në turne në New York
(*Foto 4*) Letra që Johanna Moisi – Terwin i dërgoj Max Reinhardt-it, faqja 1
(*Foto 5*) Letra e falenderimit që Johanna Moissi – Terwin i dërgoj Max Reinhardt-it, faqja 2

të brendëshëm lëvizjen përkatëse trupore e cila i dilte instinktivisht duke ndihmuar edhe në kuptimin e tekstit të vështirë, por gjithmonë pa humbur fillin e rolit dhe të pasionit që roli përmbante, duke i dhënë jetë nga qenia e tij, duke arritur të na tundojë e trazojë në shpirt ne të gjithëve. Ky aktor ishte Aleksandër Moisi.

Moisiu nuk ishte aktori i "kulturës moderne", ai që donte të binte në sy e të mundohej të krijonte famë botërore, një profil e personalitet i rëndë, ai nuk ishte një aktor mediokër, as edhe besnik i "deshirave të vogla" të autorëve. Ai është një nga sera e vjetër e aktorve, kategoria më e thjeshtë qytetare, i "pagdhenduri", njeriu pa kufij, natyra e vagabondit, ishte aktori i ndjenjave njerzore në lojën aktoriale, ishte "egërsira e zbutur", shpirti, nervat, gjaku, lëkura dhe flokët e të cilit ishin pjesë dinamike e lëvizjeve të mëdha emocionale jetësore, për tu reflektuar në veprat e çdo dramaturgu.

Moisiu krijoi një tip të ri aktori në botën e dramës: artistin e shekullit të 20-të që rrezaton vetvehten me zgjuarsi e personalitet në skenë, që vendos shpirtin në zgjidhje të çdo roli e figure skenike. Kritikët e artit janë të mendimit që: "është e tepërt të thuhet që pa Reinhardtin nuk do të kishte Aleksandër Moisi, por mund të thuhet që: Max Reinhardt u kujdes që figura e magjishme Moisi të rrezatojë në skenë. Me pak "kujdes e distancë", por mund të thuhet edhe që suksesi vezullues i Reinhardit pa Moisiun nuk do të ishte kështu siç është." (R.S. Moissi, faqe 80).

Përveç Moisiut, Reinhardt nuk ngurroi kurrë të angazhojë në skenën e teatrit gjerman, aktorë me akcent të huaj që vinin nga Hungaria, Rusia apo Amerika e kjo kishte edhe arsyet e veta ekonomike mbasi, kur luante Moisiu arka (kasa) ishte plot.

Askush nuk e "ndizte" publikun si Aleksandër Moisiu, por edhe Max Reinhardt nuk mundi që atë që ishte aktori kryesor i shfaqjeve të tija, këtë burrë që transformohej nga roli në rol me magjinë e talentit të tij, ta mbante përgjithmonë. Mbi 20 vjet punuan dy gjigandët së bashku. Ndarja ndodhi në vigjilje të luftës së parë botërore. Aktori Moisi nga skena e Berlinit u kthye në aktor shetitës, jeta e tij artistike vazhdoj nga një turne në tjetrin...

Wien, me 3 qeshor 2013